

Kujtim BUZA, Tiranë

SKENDERBEU NË MONUMENTE*

Dëshira e shqiptarëve për ta parë Skënderbeun në monumente është e kahershme. Që kur Lekë Dukagjini, duke klithur dhe vajtuar njoftoi popullin për vdekjen e Skënderbeut që nga ky moment i gjithë populli dhe princat e tij kalonin nëpër mendje figurën e të madhërismit zot dhe secili



krijonte shëmbëlltyrën e heroit legjendar, bënte Skënderbeun e tij. Edhe rilindësit tanë krijuan dhe ngritën, në mendjet e tyre, nga një monument për Skënderbeun. U bënë portrete dhe tablo kompozicionale, u punuan vizatime dhe gravura, medaljone, buste dhe statuetka nga autorë të huaj dhe pothuajse nuk mbeti artist shqiptar pa punuar Skënderbeun, bile shumë prej tyre me të e filluan jetën artistike. **Thimi Hondro punoi një statuetkë të vogël shpërndarë nëpër familje në Amerikë, që e shohim të botuar në revistën “Përpara” në vitin 1918.**

U shkruan dhe u hartuan thirrje, u mbledhën kuvende dhe komitete, këshilla dhe komisione të posaçme për ngritjen e një monumenti për Skënderbeun.

Në revistën “Ylli i mëngjesit” në vitin 1918 shprehej besimi se së shpejti do të shohim në Shqipërinë e lirë përmendoren e Skënderbeut. Bashkia e Lezhës më 10. X. 1923 i dërgon Ministrisë së Arsimit, në Tiranë, një shkresë ku kërkon “ **Ndihma për ngrehjen e përmendores së Skënderbeut**”.

* Kumtesë e mbajtur në Simpoziumin Shkencor “Gjergj Kastrioti Skenderbeu dhe epoka e tij”, Prishtinë 21 nëntor 2005.

Konkursi i vitit 1937 për Monumentin e Skënderbeut

Kaluan kohë dhe në fund të vitit 1936 komisioni i krenimit të 25 vjetorit të vetëqeverimit që u ngrit nga qeveria e Zogut, shqyrtoi shumë propozime që u bënë nga prefektura dhe nënprefektura, ministri, bashki, komuna, shoqata dhe individë, për festimin me madhësi të këtij përvjetori të rëndësishëm. Ndërmjet të tjerash u miratuan 25 manifestime dhe aktivitete, sikundër ishin: shpallja e disa monumenteve me rëndësi kombëtare, kërkimi i eshtrave të heroit tonë kombëtar dhe varrit të tij në Lezhë, ngritja e panteonit, i stacionit radiofonik, hapja e ekspozitës së Rilindjes Kombëtare, shfaqje folklorike, teatrale, ekspozita pikturë dhe skulpturë, koncerte, emetime pullash, botime pllakati dhe kartolinash. Ngritja e monumentit ishte një nga ngjarjet me kulmore të këtij përvjetori. Prandaj, Këshilli i Ministrave, me vendim Nr. 655 të datës 10 qershor 1937, vendosi për shpalljen e konkursit dhe ngritjen të monumentit të Skënderbeut në Tiranë.

Më 16 qershor 1937 konkursi u shpall në gazetën “Drita” si dhe në gazeta të tjera ku botoheshin edhe kushtet, kërkesat, afatet, mënyrat e pjesëmarrjes dhe çështje tjera teknike e administrative.

Ky është i pari konkurs ndërkombëtar, me të drejtë pjesëmarrje të artistëve të çdo kombësie qofshin, me kërkesa të sakta si ruajtja anonimatit, dhënia kompetencave të plota jurisë vendimet e të cilës ishin të paapelueshme dhe të pakontrollueshme. Dorëzimi i punimeve duhej të bëhej deri më 15 gusht 1937 duke ndjekur procedurën sekrete të dërgimit përmes pseudonimit si kriter bazë. U njoftuan përfaqësitë e akredituara aso kohe në vendin tonë.

Në konkurs u paraqitën 39 projekte nga 37 pjesëmarrës. Shumica prej tyre ishin të huaj si italianë, kroatë, bullgarë, belgë, austriakë, gjermanë, hungarezë etj. Nga artistët shqiptarë mori pjesë Odhise Paskali me 2 variante.

Komisioni Qendror, më 10 shtator 1937, njoftoi se juria përbëhej nga: Doktor Mirash Ivanaj, profesor Leon Rey, profesor Marconi, piktor Vangjush Mio, inxhinier Anton Lufi, inxhinier Luarasi dhe profesor Abdurrahim Buza. Të nesërmen, më 11 shtator, në orën 9.00 juria mblidhet në Institutin “Nana Mbretneshe” ku ishin të grumbulluara dhe të ekspozuara maketet për monumentin e Skënderbeut. Kryetari i jurisë u zgjodh Mirash Ivanaj. Pas një pune intensive e profesionale, më 15 shtator 1937, juria në përbërje të plotë

me shumicë votash, katër për (V. Mio, A. Buza, S. Luarasi dhe A. Lufi), dy kundër (Leon Rey dhe Marconi) dhe një abstenim (Mirash Ivanaj i cili ishte për projektin nr. 11 me moton 7667) vendosi që:

Çmimi i parë, në vlerë 4000 franga ari, i jepet motos “67” përkatësisht skulptorit Antun Augustinçiq dhe arkitektit Drago Goliç, që të dy, nga Zagrebi (Kroaci);

Çmimi i dytë, në vlerë 3000 franga ari, i jepet motos “ Manca il motto” punim i skulptorit Amerigo Toti dhe arkitektit Mario Seno, që të dy, nga Roma (Itali);

Çmimi i tretë, në vlerë 1000 franga ari, i jepet motos “ Gloria” përkatësisht skulptorit Gian Domenico De Marchis nga Roma (Itali);

Çmimi i tretë, në vlerë 1000 franga ari, i jepet motos “ Veritas” autorë të cilës ishin skulptori Asem Peikoff dhe piktori Georges Pojkof, që të dy, nga Sofja (Bullgari).

Përpos këtyre çmimeve juria gjithashtu mori në konsiderat dhe i lavdëroi edhe dy projekte. Projektin me moto “Le vainquer” (Fitimtari) që ishte e një belgu dhe projektin me moto “1937 A” të Odhise Paskalit.

Vendimet e jurisë ngjallën polemika dhe pakënaqësi të madhe brenda dhe jashtë Shqipërisë sidomos nga Italia. Qeveria italiane për këtë konkurs ka qenë e shumë e interesuar jo vetëm me pjesëmarrjen e gjerë, me shumë se gjysma e artisteve ishin italianë, por edhe për anën organizative dhe administrative të mbarëvajtjes, thithjen e opinioneve dhe formimin e tyre në favor të skulpturave italiane. Nuk janë të pakta informacionet, korrespondenca, letrat dhe telegramet e shkëmbyera zyrtare në mes autoriteteve më të larta shtetërore italiane dhe përfaqësuesve të tyre në Tiranë. Të dhënat dëshmojnë se më 18 shtator 1937 Jakomoni i shkruan gjeneral Parianit, në Romë, në përgjigje të letrës që ky i fundit i dërgon më 4 shtator 1937 për skulptorin De Marchis dhe maketin e tij, në mes tjerash shkruan se: “Pa qenë në gjendje të njoftoj me saktësi për konkursin e monumentit të Skënderbeut, po i përgjigjem letrës suaj të 4 shtatorit. Nuk ka pasur asnjë komunikim zyrtar dhe shtetëror mbi përfundimin këtij konkursi por nga ne do të bëhet menjëherë e ditur përpara se ti nënshtrohet hendekut të ministrit të brendshëm” (e ka fjalën për Musa Jukën që udhëhiqte komisionin e 25 vjetorit të vetëqeverimit).

Realisht ky konkurs kishte përfunduar qysh kur Çiano i dërgon Jakomonit, me 9 shtator 1937, telegramin e nënshkruar – “Riservato” përmes të cilit e informon për marrëveshjen e tij me skulptorin Romanelli dhe porosinë që jep ai për ta bërë më dije

qeverinë shqiptare dhe masat deri në anulim të konkursit, duke çdëmtuar materialisht artistët pjesëmarrës. Kjo do të thotë se gati tre javë pas afatit të dorëzimit të varianteve për konkurs dhe 2 ditë para se të mbliidhej juria për vlerësimin e punimeve, “pazaret” për monumentin ishin paraqitur.

Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e mbajtur me 9. X. 1937 (nën kryesinë e Kryeministrit Koço Kota) mori në shqyrtim dhe debatoi për vendimet e jurisë dhe vendosi për: “Dhënien e çmimit të parë prej Fr. Ari. 4000 (katërmijë) skulptorit Antun Augustinçiç, banues në Zagreb, Balltova II; Fr. Ari 3000 (tremijë) skulptorit Amerigo Toti, banues në Romë, Via Margutta 7, int. 10, si dhe nga Fr. Ari 1000 (njëmijë) skulptorëve Gian Demenico De Marchis e Asem Peikoff, banues i pari në romë dhe i dyti në Sofje St. Kliment 8, mbasi këta të dy, nga jurija, kanë fitua vota e barabarta. Me qëllim që të respektohet angazhimi i marrë prej ish Komisionit lartpërmendur dhe tue pamë se në pakicë të jurisë kanë mbet dy anëtarë, kompetenca e të cilëve mbi çështjen asht e njoftuan, dhe vendimi i kundërt i tyre më të drejtë e pengon qeverinë për grehjen e statutit të sipërpërmuëm sikurse asht vendos e pëlqye prej shumicës së zhurisë, u pa e arsyeshme lanja e mbarimit të kësaj vepre në kohën kur të jenë krye studimet si duhet e të jenë prue bindje se modeli i ofruem nga çdo pikëpamje të jetë i përsosur. Çmimet që caktohen në pjesën e parë të këtij vendimi, autorizohet me i paguem Ministria e P. Brendshme nga Kap. 24 bis Shpenzime të çdo natyre për kremtimin e 25 vjetorit të Vet-qeverimit të buxhetit të saj”.

Pra, këshilli ministror, edhe pse mbreti Zog i ndodhur nën trysininë e Romës, me gjithë ndërhyrjet, makinacionet dhe ujdite e dokumentuara, nuk shkeli dot mbi gjykimin e jurisë.

Qëndresa e katër anëtarëve të jurisë, bindjet e tyre për veprën me të mirë artistike, potencialin krijues të një artisti të madh – skulptorit kroat Antun Augustinçiç, nxënës i Meshtroviçit – Mikelanxhelo i shekullit, juri qe diti të gjykojë me objektivitet edhe pjesëmarrësit e tjerë, bëri që qeveria të jetë e kujdesshme dhe të mos kalojë në skajshmëri apo përmbyasje të gjykimeve të dhëna.

Vendimi i qeverisë se; “...Lanja e mbarimit të kësaj vepre në kohën kur të jenë krye studimet si duhet e të jenë prue bindjes e modeli i ofruem nga çdo pikëpamje të jetë i përsosur, edhe një “GJETJE” e qeverisë, jo thjeshtë për të mos pikëlluar dy anëtarë (ka parasysh Marconin dhe Rejin), që siç thuhet kompetenca e të cilëve mbi çështjen asht e njoftuan (ata ishin kryetarë të komisioneve

arkeologjike, respektivisht te Italisë dhe Francës) por edhe për të qetësuar sadopak zemërimin e qeverisë italiane dhe vazhduar lojën për angazhimin e një skulptor italian me potenciale më të mëdha profesionale. Kështu u mënjanua edhe realizimi i Skënderbeut ekuestër e Antun Augustinçit, që do të kishte qenë vlerë e shquar e skulpturës monumentale evropiane.

Kështu konkursi u mbyll me fitues por pa fitimtar, të vlerësuarit morën paratë e çmimeve që u dhanë, morën edhe maketet, të tjerat u shpërndanë. Gjithçka u shua në heshtje. Të gjithë kuptuan ku “flinte zogu”. Marrëveshjet me skulptorin italian Romanellin, që nuk kishte marrë pjesë në konkurs, kishin filluar paralelisht.

Monumenti i Skënderbeut në Romë

Sikundër u tha më lart, krahas konkursit ndërkombëtar të shpallur, dhe veprimeve të dukshme juri –komision-qeveri, zhvillohej krahu tjetër i kulisave, pas perdeve, që kërkonte me çdo kusht fitoren e një artisti italian për ngritjen e monumentit të Skënderbeut. Siç dukej, pushtimin fashist të Shqipërisë parashikohej ta “ambalazhonin artistikisht”, me sjelljen edhe të Skënderbeut në bronz. Pra, simbolin tonë të lirisë do ta shoqëronin tani trupat balitë më pende këndesi e dhembë hekuri.

Se ky ishte një skenar i krahut ushtarak të qeverisë italiane duket fare qartë përmes dokumentesh.

Në telegramin (rezervat) që konti Çiano i dërgon Jakomonit – përfaqësues i qeverisë italiane në Shqipëri, me datë 9 shtator 1937, i thotë: “Në rast se shteti vendos të pranojë kushtet e propozuara nga akademiku Romanelli, këto mund të mjaftojnë për t’u vënë në kontakt të drejtpërdrejtë me Tiranën. Në këtë rast, konkursi i shpallur, fiksuar me data precize, duhet të anulohet dhe artistët italianë që kanë marrë pjesë duhet në një farë mënyre të zhdëmtohen”. Më 18 shtator 1937, Jakomoni i shkruan gjeneralit Alberto Partianit, Nënsekretar i Luftës në Romë se: “Ministri Musa Juka është i vendosur të anulojë menjëherë konkursin, ta bëjë këtë fakt të kryer dhe të përsërisë kërkesën që deri në fund të verës së vitit të ardhshëm, të ftojë në emër të qeverisë shqiptare, një artist të madh italian, mundësisht Romanellin – që të marrë përsipër punën e përgatitjes së buxhetit përfundimtar të monumentit të Skënderbeut. Po në këtë letër Jakomoni vazhdon më tej:

“Gjeneral Serreqi si dhe anëtarë të ndryshëm të qeverisë, në përgjigje të insistimit të tyre që të arrihet ndërhyrja e Romanellit, mundem të dallojmë shumë të pakënaqur nga kjo ngjarje që duket krejt e paligjshme ndërmjet veprimeve të qeverisë dhe kjo e komisionit gjykues...”

Në këtë drejtim të bënë përshtypje korrespondenca me gjeneralë të ushtrisë italiane, preokupimi i tyre i madh dhe këmbimet e informacionit me përfaqësuesit e Legatës Italiane .

Edhe komunikimet me qeverinë shqiptare bëheshin përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe madje opinionet e ushtarakëve shqiptarë si Gjeneral Serreqi etj., vlerësoheshin dhe gjykoheshin si të drejta dhe përdorshin si mbështetje.

Mirëpo edhe Romanelli, skulptori i ofruar për realizimin e monumentit të Skënderbeut ishte ushtarak dhe tradicionalisht familja e tij ishte familje ushtarakesh.

Pas disa takimesh, bisedash dhe komunikimesh me skulptorin, me ndërmjetësimin e posaçëm dhe fillestar të Kontit Çiano, Ministri i Punëve të Brendshme i Mbretërisë Shqiptare Musa Juka, përmes Drejtorisë së Korrespondencës Nr. 1589/64 gusht 1938 njofton :

“Konform vendimeve të marrun me kohë për ngrehjen e monumentit të Skënderbeut, kjo ministri ka hue në marrveshjtje me të mirë-njoftonin Romano-Romanellin për ti ngarkue këtij plotësimin e kësaj vepre mbasi, tue marrë parasysh cilësina e tija të rralla artistike dhe poziten që i ka ngarkue Qeveria Mbretnore Italiane, na ep besim të plotë se do të bajë një monument vërtetë të shkëlqyeshëm, dë denjë për Heroin tonë Kombëtar”. Dhe vazhdon më tutje me të dhëna se “monumentit do të kushtojë 60.000 Fr. Ari bashkë me piedestalin dhe do të jetë i lartësisë 8-10 m” .

Pas 8 ditësh mblidhet Këshilli i Ministrave dhe merr vendimin përkatës duke ia besuar plotësisht Romano Romanellit realizimin e monumentit të Skënderbeut.

Këshilli i Ministrave me vendim Nr. 929 të datës 17. 8.1938, nën kryesinë e Koço Kotës Kryeministër dhe Zëvendësministër i Punëve Botore dhe Punëve të Jashtëme bashkë me ministra tjerë, pasi mori në shqyrtim shkresën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për ngritjen e monumentit nga Romanelli, vendosi “t’autorizojë Ministrinë e Punëve të Brendshme me ri-hye në marrëveshje me skulptorin...”.

Mbi gjashtë muaj iu desh skulptorit të merrej vesh nëpër zyra e të binte në ujdi mbi kushtet, detyrimet e skulptorit dhe angazhimet e

porositësit, problemet e vendit ku do të ngrihej monumenti dhe detaje të tjera.

Vetëm më 12 dhjetor 1938 nënshkruhet kontrata e shumëpritur ndërmjet skulptorit Romano Romanelli dhe përfaqësuesit shqiptar në Romë, diplomatit Dhimitër Herati.

Në kontratë shënohet se qeveria shqiptare ka ndër mend me vizitue modelin në studion e profesor Romanellit në Firencë, prej datës 1 deri më 15 mars 1939.

Skulptori fillon nga puna e hocetit, fotografitë e të cilit ia dërgon Musa Jukës me porosi që ato të kthehen sa më parë pasi të shihen nga një rreth i ngushtë me qëllim mbrojtje të së drejtës së autorit. Përgjigja e Musa Jukës ishte: “Vendimi i merituar nga Madhëria e Tij Mbreti Zog dhe Këshilli i Ministrave do arrihet brenda javës. Ju siguroj me çdo mënyrë evitimin e çdo shqetësimi për përvetësimin padrejtësisht të projektit nga ana e”.

Monumenti i Skënderbeut ju besua nga fillimi e deri në fund Romanellit. U aprovua nga një bocet i fotografuar. Nuk u ndoq dhe as u pa gjatë realizimit nga asnjë përfaqësi shtetëror, ndonëse ishte vendosur për nevojën e kolaudimit të modelit gjatë punës.

“ . . . nuk ka nevojë për kolaudim të modelit tue pasë besim të plotë në zotsin artistike të skulptorit” – thuhej në Këshillin e Ministrave.

Monumentin, Romanelli e përfundoi ashtu sikundër e mendoj vetë, pa asnjë sugjerim dhe vërejtje nga porositësi zyrtar apo opinioni kulturor shqiptar. Për herë të parë kjo vepër u pa e vendosur në allçi u pa në ekspozitën e parë triennale të tokave italiane përtej detit, gjatë muajve mars – qershor të vitit 1940, ku në të ishin ekspozuar: Basoreliefi i Bruno Innocentit, panelli “Shqipëria romane” e Primo Kontit dhe “Shqipëria fashiste” e Xhami Vanjetit.

Në vitin 1941 kjo vepër u derdhë në bronz dhe u vendos në sheshin “Albania”. Në pedestalin e tij janë gëdhendur fjalët “MBROJTËS I PAEPUR I QYTETËRIMIT PËRENDIMOR”.

Megjithatë, duhet pranuar se është e para skulpturë – ekuester e Skënderbeut. Është e para dhe e vetmja e vendosur jashtë shtetit, në Romë, në kryeqytetin evropian të kulturës dhe artit, në një shesh të rëndësishëm që mban emrin “Sheshi Shqipëria” (Piazza d’Albania”).

Monumenti i Skënderbeut në Krujë

Me rastin e 15 vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, ditën e premte më 27 nëntor 1959, ora 9.00 paradite ne qytetin e Krujës inaugurohet Monumenti i Skënderbeut – vepër e skulptorit Janaq Paço.

U deshën 10 vjet punë qysh nga vendimi nr. 9 datë 17 janar 1949 i Këshillit Ministerial të R.P. të Shqipërisë, firmosur nga Gjen. Kol. Enver Hoxha, për realizimin e kësaj vepre të rëndësishme monumentale.

Konkursi i shpallur për ngritjen e monumentit të Gjergj Kastrioti- Skënderbeut u shpall me propozim të Komiteti t’Arteve dhe Kulturës më 15 janar 1949, pas dhjetë muaj pune, komisioni i ngritur nga qeveria dha gjykimin mbi punimet e paraqitura.

Komisioni i përbërë nga Abdurrahim Buza, Aleks Buda, Andon Lufi, Dhimitër Shuteriqi, Foto Stamo, Mark Ndoja, Misto Treska, Sadik Bekteshi, Sadik Kaceli, Skënder Luarasi, Spiro Koleka (kryetar), Shefqet Musaraj dhe Zihni Sako (sekretar) pas dorëzimit të maketeve filloi nga puna menjëherë. Kësaj radhe në konkurs muarën pjesë : O. Paskali – me pseudonimin “Një nga shokët”; A. Mano – me pseudonimin “Guri”; J. Paço – me pseudonimin “Silva”; U. Nikolla – me pseudonimin “Puna” dhe Dh. Çani – me pseudonimin “Kështjella”. Me 4 qershor 1949 fillon punën juria. Ajo mbajti 7 seanca, puna e saj zgjati deri më 15 gusht 1949, duke i dhënë fund shqyrtimit të konkursi kombëtar i cili përfundoi pa çmim të parë.

Nga bocetet e pjesëmarrësve në konkurs varianti “Silva” i Janaq Paços, paraqitej më i miri, sipas jurisë, prandaj edhe në konkurrim me variantet “Një nga shokët” (O. Paskali) dhe “Guri” (të A. Manos) u çmua si më i arritur por jo për çmim të parë por të dytë, prandaj simbas rregullores boceli që fitoi çmim të dytë mund të ngrihet në Krujë, gjithmonë me sugjerimet e jurisë.

Pra konkursi i parë kombëtar për Skënderbeun nuk arriti rezultate të kënaqshme. Prandaj, menjëherë Këshilli Ministror i RPSH, për të pasur një monument më të realizuar për Tiranën, rishpalli konkursin e dytë për monumentin e Skënderbeut.

Skulptori Janaq Paço në variantin “Silva” me të cilin fitoi konkursin e paraqiste heroin në moment sulmi të furishëm ku kali i kishte të dy këmbët para në hedhje: kalë që fluturonte në hapësirë. Mirëpo më vonë, në vitin 1954, mbi bazën e vërejtjeve dhe sugjerimeve të shumta, autori bëri tri ndryshime të rëndësishme:

Skënderbeut ia uli dorën e djathë, i mbështeti në tokë njërën këmbë të kalit (të majtën) dhe e veshi heroin me pelerinë. Pra ndryshoi e gjithë zgjidhja kompozicionale, nga figurë shpate – ngritur në një lëvizje tjetër gatishmërie, nga një kalë që hovte përpara, në një kalë që ngulet në vend. Megjithatë autori nuk “stacionoi”, ai vazhdoi me këmbëngulje kërkimet deri në përkryerje. Skulptori realizoi edhe një variant tjetër në allei, në dimensione 1,5 m, bocet i qe pëlqyer më shumë për importimin dhe përkryerjen artistike të figurës lidhur me kalin. Ishte koha kur në studio përveç kolegëve, shkrimtarëve e artistëve ishte ftuar (janar 1954) edhe skulptori sovjetik Tomskij.

Historia e realizimit përfundimtar të kësaj vepre, që zgjati 10 vjet punë (janë vite të mundimshme dhe shkollë e madhe), konsulta, vërejtje, eksperimentime që nga fillimi e deri në derdhjen në bronz në Budapest. Skulptori i madh hungarezë Zigmund Kishfaludi Shtrobël kur e pa monumentin mes tjerash shkroi: “Kolegut tim Janaq Paço me rastin e paraqitjes së monumentit të tij të mrekullueshëm ekuester “Skënderbeu”. Monumenti është një vepër monumentale dhe shpreh plotësisht përmbajtjen e tij historike”.

Monumenti i Skënderbeut në Krujë i lartë 12 m (6 m skulptura dhe 6 m bazamenti projektuar nga arkitekti Sokrat Mosko), derdhur në bronz, u realizua pas një pune 10 vjeçare.

Monumenti i Skënderbeut në Tiranë

Duke qenë se konkursi i parë për monumentin e Skënderbeut për Tiranën nuk ia arriti qëllimit, atëherë këshilli i Ministrave të R.P. të Shqipërisë, më 27. X. 1949, vendosi dhe urdhëroi Komitetin e Kulturës dhe Arteve të shpallë një konkurs tjetër kombëtar për ngritjen në Tiranë të monumentit të Skënderbeut.

Konkursi, u shpall më 6.XII.1949. Afati i fundit për dorëzimin e projekteve ishte caktuar data 30 shtator e vitit 1950. Mirëpo, me gjithë përpjekjet e institucioneve shtetërore, veçanërisht të Komitetit të Kulturës dhe Arteve, në konkurs morën pjesë vetëm katër konkurrentë, me pseudonimet: “Kruja”, “Dajti”, “Shkëmbi” dhe “Fleta”. Pra morën pjesë 4 autorë me 5 boceta (njëri prej tyre paraqiti dy variante).

Më 19 janar 1951, dy muaj e gjysmë pas përfundimit të afatit, në Klubin e Kulturës në Tiranë, Komiteti i Kulturës dhe Arteve shpalli fituesit e konkursit.

Juria, me kryetar Foto Stamon dhe anëtarë: Abdurrahim Buza, Sadik Kacelin, Nexhmedin Zajmin dhe Kristina Hashin, çmimin e parë ia dha përsëri skulptorit Janaq Paço që mbante pseudonimin “Kruja” duke i dhënë 80.000 lekë dhe duke e vlerësuar veprën e tij një punim artistik të denjë për një monument për Skënderbeun në Tiranë. Çmimi i dytë prej 50.000 lekësh ju dha konkurruesit me pseudonimin “Fleta” që ishte piktori Bukurosh Sejdi. Ndërsa varianti “Shkëmbi” të mos vlerësohet për të meta në përmbajtje dhe formë, ndërsa ai me pseudonimin “Dajti” të nxirret jashtë konkursit për mungesa të theksuara profesionale.

Edhe ky variant i J.Paços për Tiranën e paraqiste Skënderbeun në sulm me të dy këmbët e para të kalit ngritur, vendosur mbi një pedestal shkëmbor, dhe dy altoreliefe (relief të lartë) në të dy anët. Përpara qëndronte një figurë që personifikonte “fitoren”.

Deri në vitin 1957 skulptori Janaq Paço punonte edhe për Krujën edhe bocelin për Tiranën. Duke parë vështirësitë si edhe vërejtjet e vazhdueshme të specialistëve, jurisë dhe personave me përgjegjësi, nga mesi i vitit 1957 u thirren në Komitetin Qendror ku ishin prezent Nexhmije Hoxha, Misto Treska, Vaske Aristidhi, Foto Stamo, Janaq Paço, Odise Paskali e Andrea Mano dhe u vendos që veprën ta punojnë bashkërisht O. Paskali, J. Paço dhe A. Mano. U bënë fillimisht 40 skica nga të cilat u zgjodhën 6 që u kthyen në makete. Më vonë puna përfundoi në 3 makete derisa u realizua varianti 1,5 m. Faza e parafundit ishte zmadhimi i studiuar i këtij maketi në lartësinë 3 m d.m.th. sa gjysma e vetë monumentit.

Gjatë punës u konkludua në një zgjidhje tjetër, jo ajo që fitoi konkursin, por kjo që është në sheshin “Skënderbeu”. Fillimisht u mendua për një bazament kuadrat, i rregullt dhe i karakterit klasik, në bashkëpunim me arkitektet Gani Strazimiri, dhe Koco Miho. Por me insistimin e O. Paskalit piedestali mori formën e një shkëmbi (këtë ide e pati fillimisht edhe J. Paço në variantin që fitoi çmimin e parë), me 40 blloqe shkëmbore të nxjerrë dhe gdhendur në Krujë (çdo bllok afërsisht 2 m³ vendosur mbi një “zemër” betoni 60-70 m³). Bazamenti ka dimensione: 4.60 m lartësia nga sheshi, nga lulishtja 6.40 m, gjerësi rreth 3-3,5 m dhe gjatësi 11 m. Paskali mendonte që në lulishte të shpërndareshin të lirë disa gurë, por që, edhe pse u lanë për ca kohë, u hoqën si të panevojshëm.

Monumenti, kalë e kalorës është 6.30 m i lartë kurse me bazamentin 11 m. Vepra u derdh në bronz në Itali . Përrurimi i kësaj vepre u bë më 11 janar 1968 në prani të autoriteteve më të larta partiake e shtetërore.

Monumenti i Skënderbeut në Prishtinë

Ndonëse monumenti ekuestër i Skënderbeut në Prishtinë është kopje e atij të ngritur në Krujë, vlerat janë të rëndësishme e të pa imagjinueshme.

Të vijë Skënderbeu në bronz, në Prishtinë, dhe të përurohet më 28 Nëntor 2001 pasi ka udhëtuar këtë ditë në Kosovë, kjo ka qenë ngjarje më e madhe se sa kur u ngrit në Krujë më 27 Nëntor 1959. Është meritë e popullit kosovar dhe e atyre që u morën me ngritjen e këtij monumenti, me realizimin dhe vendosjen e përmendores së kryetrimt Gjergj Kastrioti në qendër të Prishtinës.

Vepra është e njëjtë me atë të Krujës. Kjo praktikë nuk është as e para dhe as e fundit. Në historinë e artit shembujt janë të shumtë, aq më shumë për vepra të arrira artistikisht dhe me vlera të pakontestueshme. Momenti kërkonte që të ngrihej edhe në kryeqendrën e Kosovës ajo çka është më e shenjtë për çdo shqiptar. Skënderbeu personifikon lirinë, vulos përfundimisht atë çka ka dëshiruar secili, konkretizon ëndrrën shekullore që në Kosovë kishte vlera të shumëfishta aktuale.

Zërat se mund të bëhej kështu apo ashtu, ky apo ai, nesër apo pasnesër, vononin ngritjen e simbolit të fitores. Skënderbeun, më siguri do ta bëjnë përsëri edhe më mirë brezat që do të vijnë, në sheshe dhe hapësira tjera dhe të studiuara nga ana urbanistike dhe arkitektonike. Por me krijimin e mjediseve në zhvillim, monumentet edhe lëvizin, sidomos këto me kalë. Gjëja e re në këtë rast është sheshi “Gjergj Kastrioti” në Prishtinë, në qendër të hapësirës së ngushtë që e rrethojnë objektet e Teatrit Kombëtar dhe Shtëpisë së mallrave, Unionit, Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, punim i arkitektit Lulëzim Nixha dhe gjithë atyre që e ndërtauan.

Monumenti në Krujë është i vendosur në një lartësi ku soditet kryesisht në skorcio (nga poshtë) e ku zbulohen siluet ekspresive me sfond malet e Krujës gjë që e bëjnë tepër befasues. Pikat nga afër janë të pakta aq më shumë nga pozicione horizontale. Monumenti në Krujë lidhet gjithashtu me tribunën përpara dhe një hapësirë tepër të kufizuar që përdoret në raste tubimesh.

Në Prishtinë monumenti i njëjtë gjendet në një situatë krejt të re. Ai si të thuash ka zbritur nga lart dhe qëndron në shesh, mes njerëzve që e shohin dhe qarkullojnë rreth tij në një amfiteatër që pranon mbi 1000 vetë, me diametër 26 m, zbavitur në 6 shkallë me shumë se 1 m nën nivelin e hapësirës që e rrethon me simbolikë – të bashkuar rreth lirisë, fitores, kryetrimt.

Mendoj se zbritja në shesh e këtij monumenti krijon mundësi për ta shijuar atë si skulpturë nga të gjitha anët, për të ndjerë plastikën e ngrohtë të mjeshtrit Paço deri në detaje. Unë mendoj se, në qoftë se në Krujë monumenti qëndron imponant dhe ngrihet madhështor me efekte monumentale, zeusiane ta themi, këtu në Prishtinë është më tokësor. Sidoqoftë janë dy zgjidhje të ndryshme në vendosje që kanë vlera dhe zbulojnë një vepër monumentale tepër prestigjioze. Shoqërimi me katër fontana që simbolizojnë katër anët tona etnike dhe kthetrat e shqiponjës vendosur në ekstremet e tyre plotësojnë gjithë simbolikën e kësaj vepre që ngrihet në siluete të bardha plisash që i japin lartësi dhe sigurisht plotësojnë idenë e heroit kombëtar.